



MODELE PYETJESH NGA MËSUESIT PËR MËSUESIT

ARSIMI I MESËM I ULËT DHE ARSIMI I MESËM I LARTË

LËNDA:

GJEOGRAFI

**TETOR
2021**

MODELE PYETJESH NGA MËSUESIT PËR MËSUESIT
ARSIMI I MESËM I ULËT DHE ARSIMI I MESËM I LARTË

LËNDA: GJEOGRAFI

TETOR 2021

Materiali “Modele pyetjesh nga mësuesit për mësuesit ”, lënda “Gjeografi”, u hartua nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) në bashkëpunim me mësues të lëndës së gjeografisë në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë.

Koordinoi punën për hartimin e materialit

Evis Mastori, ASCAP

Koordinoi redaktimin shkencor

Dr. Gerti Janaqi, ASCAP

Dr. Dorina Rapti, ASCAP

Koordinoi redaktimin letrar

Erida Koleci, ASCAP

Rozeta Hyseni, ASCAP

Koordinoi faqosjen

Esion Zgjana

Prodhim i ASCAP-it, 2021

www.ascap.edu.al

© Copyright 2021. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për ASCAP, Tiranë, Shqipëri

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	3
HYRJE	4
KLASA VI.....	5
KLASA VII.....	14
KLASA VIII	22
KLASA IX.....	29
KLASA X	36
KLASA XI.....	44
KLASA XII.....	52

HYRJJE

Pyetja është mjete më i fortë në dispozicion të mësuesve që t'i mësojnë nxënësit si të mendojnë. Ata bëjnë qindra pyetje çdo ditë, të cilat shërbejnë për të monitoruar vëmendjen e nxënësve, për të hapur biseda dhe diskutime, për të promovuar ndërveprimin nxënës-nxënës, për t'i angazhuar nxënësit në detyra individuale dhe punë në grup, për të përpunuar informacionin, për të inkurajuar të menduarit e pavarur dhe kritik, për ta lidhur dhe zbatuar informacionin me/në situata të jetës reale etj.

Kurrikula që zhvillon kompetencat, kërkon nga mësuesi që pyetjet të mos përqendrohen vetëm në riprodhimin e njohurive lëndore, por edhe në zhvillimin e aftësive, vlerave dhe qëndrimeve. Shumëllojshmëria e pyetjeve dhe nivelet e tyre zhvillojnë kompetencat lëndore, të cilat shprehen nëpërmjet rezultateve të të nxënësve.

Modelet e pyetjeve nga mësuesit për mësuesit bazohen në udhëzuesit kurrikularë të lëndës së gjeografisë për AMU-në dhe AML-në dhe janë pyetje, të cilat mund të përdoren në teste të ndryshme. Këto modele janë hartuar nga vetë mësuesit dhe janë përpjekje e tyre për të zbatuar parimet e kurrikulës me kompetenca. ASCAP ka përzgjedhur disa modele të cilat mund t'u vijjnë në ndihmë mësuesve të tjerë. Në këtë material ndihmës për mësuesit, për çdo pyetje është dhënë kompetenca që zhvillon, rezultati i të nxënësve, lloji i pyetjes dhe pikëzimi.

KLASA VI

Pyetja 1:

Europianët janë tërhequr prej kohësh nga India e pasur në burime natyrore dhe produkte të ndryshme. Portugezët ishin të parët që filluan të ndërmarrin ekspedita detare, duke kërkuar rrugë të reja për në Indi dhe vendet e tjera të pasura të Lindjes. Rrugën e re detare prej Europës për në Indi e zbuloi lundërtari portugez:

- A) Kristofor Kolombi
- B) Vasko de Gama
- C) Ferdinand Magelani
- D) Ameriko Vespuçi

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.



Rezultati i të nxënit: Diferencon ngjarje të rëndësishme të historisë së zhvillimit gjeografik.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 2:

Gjeografët e përshkruajnë një vend mbi bazën e dy lloj karakteristikave: fizike dhe humane. Është pjesë e karakteristikave fizike të një vendi:

- A) Gjuha
- B) Vallet popullore
- C) Relievi
- D) Njerëzit e shquar

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.


Rezultati i të nxënit: Demonstron përmes shembujve kuptimin e koncepteve që përdoren nga gjeografët për organizimin e kërkimeve të tyre.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 3:

Profesioni i gjeografit jep mundësi punësimi në fusha të ndryshme. Përcaktoni tri ndër fushat ku mund të kontribuojë/punojë një gjeograf.



Kompetenca: Marrja e vendimeve.

Rezultati i të nxënit: Diskuton mbi rolin e gjeografit në studimin e dukurive fizike dhe humane gjeografike, kontributet që i sjellin shoqërisë.


Lloji i pyetjes: Pyetje me plotësim.

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 4:

Arkidi është i pasionuar për ngjitjet në mal. Ai po planifikon që së bashku me disa nga anëtarët e ekipit të tij të ngjiten në disa prej majave të maleve në Evropë. Për t'u orientuar në lidhje me vendndodhjen dhe lartësinë e tyre i duhet të gjejnë një hartë.

a) Përcaktoni çfarë lloji janë hartat e mëposhtme:



Hartë

Hartë

b) Në cilën prej këtyre hartave Arkidi dhe shokët mund të gjejnë informacionin që u nevojitet?

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Dallon lloje të ndryshme të hartave gjeografike.

Lloji i pyetjes: Pyetje me plotësim dhe me përgjigje të shkurtër.

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 5:

Shënoni (V) për pohimet e vërteta dhe (G) për pohimet e gabuara:

A) Sa më e vogël të jetë shkalla e zvogëlimit, aq më shumë zgjerohet hapësira e paraqitur.

B) Elementet kryesore të hartave janë ngjyrat dhe shenjat konvencionale. _____

C) Paralelet në glob kanë gjatësi të barabartë. _____

D) Meridiani i Grinuiçit ndodhet në gjatësi gjeografike 180° . _____

Kompetenca: Përpunimi i informacionit gjeografik.

Rezultati i të nxënit: Krahason hartën, planin dhe globin duke treguar ngjashmëritë dhe ndryshimet mes tyre; shpjegon legjendën e një harte gjeografike.


Lloji i pyetjes: Pyetje “E vërtetë/E gabuar”.

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 6:

Sipas organizimit administrativo-territorial, territori i Shqipërisë ndahet në 12 qarqe të cilët përfshijnë 61 bashki.

- Përcaktoni në hartën administrative të Shqipërisë bashkinë në të cilën ndodhet vendbanimi juaj.
- Përshkruani vendndodhjen relative të bashkisë ku ndodhet vendbanimi juaj.



Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; Përpunimi i informacionit gjeografik.


Rezultati i të nxënit: Interpreton në hartë vendndodhjen e zonës (fshatit/qytetit) ku banon.

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar.

Pikëzimi: 2 pikë

Pyetja 7:

Figura e mëposhtme paraqet planin e katit të parë të një shkolle 9-vjeçare, me shkallën e zvogëlimit 1:500.



Duke përdorur *anët e horizontit (veri, jug, lindje, perëndim)*, përcaktoni vendndodhjen e mjediseve të shkollës:

- Klasa 2 ndodhet nëtë klasës 1 dhe nëtë drejtorisë së shkollës.
- Salla e mësuesve ndodhet nëtë klasës 3 dhe nëtë korridorit.

- Biblioteka e shkollës dhe palestra ndodhen nëtë korridorit.

Kompetenca: Përpunimi i informacionit gjeografik.


Rezultati i të nxënit: Përcakton vendndodhjen relative të një vendi.

Lloji i pyetjes: Pyetje me plotësim.

Pikëzimi: 5 pikë

Pyetja 8:

Mbështetur në hartën e mëposhtme, përcaktoni koordinatat gjeografike të pikave A, B, C dhe D.



Pika A _____

Pika B _____

Pika C

Pika D

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; Përpunimi i informacionit gjeografik.

Rezultati i të nxënit: Përcakton vendndodhjen absolute në një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike.

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar.


Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 9:

Një ndër ishujt më të veçantë në rruzullin tokësor është ishulli i Pashkëve. Ishulli i Pashkëve është i famshëm për statujat e mëdha moai të gdhendura midis viteve 1250 dhe 1500. Ishulli konsiderohet gjithashtu një vend i Trashëgimisë Botërore të UNESCO -s. Ai është i vendosur në Oqeanin Paqësor, pranë brigjeve të Kilit në Amerikën Jugore. Koordinatat gjeografike të këtij ishulli janë 27° gjerësi gjeografike jugore dhe 109° gjatësi gjeografike perëndimore. Historia më tronditëse e Ishullit të Pashkëve është degradimi mjedisor. Palmat, që dikur mbulonin ishullin, thuhet nga gojëdhënat se u prenë nga popullata Rapa Nui për të lëvizur statujat. Zhdukja e pyjeve çoi në erozion të tokës, në dëmtimin e bujqësisë dhe mungesën e ushqimit. Shoqëria pati probleme të urisë dhe luftëra klanore, për shkak të burimeve të pakta.

- a) Përcaktoni në hartën e botës vendndodhjen e këtij ishulli.
- b) Identifikoni cili ndër faktorët, ai natyror apo njerëzor, çoi në shkatërrimin e pyjeve të ishullit.

c) Cilat janë dy ndër pasojat e degradimit mjedisor të ishullit të Pashkëve?



Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik; marrja e vendimeve.

Rezultati i të nxënit: Përcakton vendndodhjen absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike.

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar.

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 10:

Toka, planeti ynë po përballlet çdo ditë e më shumë me ndotjen e ujit, ajrit dhe mjedisit. Pasojat e kësaj ndotjeje të madhe do i vuajnë më shumë brezat që do të vijnë.

Jepni tre alternativa zgjidhjeje/rrugë veprimi, si mund të veprojmë ne sot në mjedisin tonë lokal për të ndikuar në frenimin e ndotjes së mëtejshme të planetit.

Kompetenca: Marrja e vendimeve.

Rezultati i të nxënit: Parashtron ide me (shkrim dhe me gojë) mbi ndikimin e veprimtarisë së njeriut në mjedisin natyror të zonës dhe nevojën e bashkëpunimit komunitet-qeverisje lokale për mbrojtjen e mjedisit.



Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar.

Pikëzimi: 3 pikë

KLASA VII

Për t'ju përgjigjur pyetjes 1 dhe 2, referojuni figurës së mëposhtme.

Figura e mëposhtme tregon pozicionin e Tokës kundrejt Diellit më datë 22 dhjetor (solstici dimëror).



Pyetja 1:

Çfarë ndodh gjatë solsticit dimëror në Hemisferën Veriore?

- A) Dita zgjat 24 orë në Tropikun e Veriut.
- B) Gjatësia e ditës zgjatet duke shkuar drejt Rrethit Polar të Veriut.
- C) Gjatësia e ditës zvogëlohet duke shkuar drejt Rrethit Polar të Veriut.
- D) Dita është e barabartë me natën në Tropikun e Veriut.

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.

Rezultati i të nxënit: Dallon pasojat e qarkullimit të Tokës rreth Diellit.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 2:

Çfarë rrobash do të merrnit me vete, nëse do të shkonit në Australi gjatë solsticit dimëror?

- A) Do të merrnit rrobat e verës.
- B) Do të merrnit rroba e pranverës ose të vjeshtës.
- C) Do të merrnit rrobat më të trasha, pasi atje bën shumë ftohtë në këtë periudhë.
- D) Do të merrnit të njëjtat rroba, pasi Australia ka të njëjtën klimë me Evropën në këtë periudhë.

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.

Rezultati i të nxënit: Dallon pasojat e qarkullimit të Tokës rreth Diellit.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 3:

Tea po bisedonte me një shoqe, e cila po i fliste për vendin e vet. Ajo po i tregonte Teas që në vendin e saj, Dielli lind për çdo ditë të vitit rreth orës 06:15 dhe perëndon rreth orës 18:15. Tea u çudit, pasi në Shqipëri Dielli lindte dhe perëndonte në kohë të ndryshme gjatë vitit.

Në cilat gjerësi gjeografike gjendet vendi që jeton shoqja e Teas?

- A) Në gjerësitë gjeografike polare.
- B) Në gjerësitë gjeografike mesatare.
- C) Në gjerësitë gjeografike tropikale.
- D) Në gjerësitë gjeografike ekuatoriale.

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.


Rezultati i të nxënit: Tregon lidhjen midis pozicionit të Tokës kundrejt Diellit dhe gjatësisë së ditës dhe natës.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 4:

Në hartën e mëposhtme jepen dy qytete: Hopedale dhe Stornway. Temperatura e janarit në Hopedale shkon deri në -19°C , ndërsa e korrikut deri në 17°C . Në qytetin e Stornway temperatura e janarit shkon deri në 5°C , ndërsa e korrikut deri në 15°C . Pse Stornway ka një klimë më të butë se sa Hopedale?



- A) Pranë qytetit të Stornway kalon rryma e ngrohtë e Golfstrimit, që ndikon në zbutjen e klimës.
- B) Pranë qytetit të Stornway kalon meridiani fillestar (i Grinuiçit), që ndikon në zbutjen e klimës.
- C) Stornway gjendet në Hemisferën Lindore, që ka një klimë më të ngrohtë sesa Hemisfera Perëndimore.
- D) Stornway gjendet më pranë ekuatorit dhe për pasojë erërat e ngrohta të pasateve ndikojnë në zbutjen e klimës.

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.

Rezultati i të nxënit: Analizon faktorët që ndikojnë në formimin e klimës.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 5:

Shtresa ose mburoja e ozonit gjendet në një prej shtresave të atmosferës dhe thith shumicën e rrezatimit ultraviolet të Diellit, duke siguruar mbrojtjen e jetës në Tokë. Në cilën shtresë të atmosferës gjendet ozoni?

- A) Troposferë
- B) Stratosferë
- C) Jonosferë
- D) Ekzosferë

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Identifikon shtresat e atmosferës dhe përbërësit kryesorë të tyre.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa.


Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 6:

Kapiteneria e një anijeje që po përgatitej të lundronte në det për një kohë relativisht të gjatë, e pa të nevojshme të studionte paraprakisht gjendjen e motit dhe të detit për ditët në vazhdim. Cili nga elementet e valës detare është më i rëndësishëm për ecurinë e lundrimit?

- A) Baza e valës.
- B) Lartësia e valës.
- C) Kreshta e valës.
- D) Gjatësia e valës.

Elementet e valës detare



Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Identifikon elementet e valës detare.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 7:

Korja e Tokës është e ndërtuar nga shkëmbinjtë me prejardhje, përbërje, ngjyrë, fortësi, pamje dhe kohë të ndryshme të formimit. Sipas mënyrës së formimit, shkëmbinjtë ndahen në shkëmbinjtë magmatikë, shkëmbinjtë sedimentarë dhe shkëmbinjtë metamorfikë.

Shkëmbi i treguar në figurë është i përbërë nga kristale të mëdha të cilat janë formuar nga:

- A) Shkëputjet tektonike
- B) Fosilet e skeleteve
- C) Ftohja e magmës
- D) Tjetërsimi

Shkëmb vullkanik



Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.


Rezultati i të nxënit: Klasifikon shkëmbinjtë sedimentarë, metamorfikë dhe vullkanikë.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 8:

Figurat e mëposhtme tregojnë pozicionin e Tokës dhe të Hënës përkundrejt Diellit në periudha të ndryshme kohore.



Shënoni (V) e vërtetë ose (G) e gabuar për pohimet e mëposhtme:

- 1) Figura 1 dhe 3 tregon që ndodh batica më e madhe. _____
- 2) Figura 2 dhe 4 tregon që ndodh batica më e madhe. _____
- 3) Figura 1 dhe 2 tregon që ndodh batica më e madhe. _____
- 4) Figura 3 dhe 4 tregon që ndodh batica më e madhe. _____

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Analizon formimin e baticave dhe zbaticave.

Lloji i pyetjes: Pyetje "E vërtetë/E gabuar".


Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 9:

Arbi jeton në Gjermani dhe dëshiron të shkojë me prindërit për pushime. Ai ka dëgjuar shumë për tërmetet dhe në fakt i ka shumë frikë, edhe pse asnjëherë nuk ka përjetuar vetë ndonjë tërmet.

Harta e mëposhtme tregon shpërndarjen e pllakave tektonike si edhe kufijtë midis tyre.

- a) Cilën nga zonat në hartën e mësipërme (A, B, C apo D) **NUK** do t'i sugjeronit Arbit për të shkuar me pushime, në mënyrë që ai mos të ketë gjasa të përjetojë tërmetin?



- b) Jepni një argument për të mbështetur përgjigjen tuaj.

Kompetenca: Marrja e vendimeve.

Rezultati i të nxënit: Identifikon zonat sizmike në planetin tonë; argumenton shkaqet e lëvizjeve sizmike.

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar.

Pikëzimi: 2 pikë

Pyetja 10:

Fotoja e mëposhtme tregon një nga llojet e peizazheve që formohen nga veprimtaria e ujërave nëntokësore.



- Në cilët lloje shkëmbinjsh formohet një peizazh i tillë?
- Emërtoni format e relievit që tregohen me shigjetë në foto.

Shigjeta 1: _____

Shigjeta 2: _____

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Identifikon llojin e shkëmbinjve ku ndodh procesi i karstit; emërton format e relievit që formohen.

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar

Pikëzimi: 3 pikë

KLASA VIII

Pyetja 1:

Cili është termi/koncepti që përdorin gjeografët kur klasifikojnë një zonë me tipare të veçanta që dallon nga një zonë tjetër?

- A) Vendndodhje
- B) Orientim
- C) Rajon
- D) Lëvizje

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Përdor konceptin e rajonit për të përshkruar modele të thjeshta të ndërvarësisë midis rajoneve.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 2:

Nëse një grup turistësh dëshirojnë të shkojnë nga veriu i Francës në Britaninë e Madhe, do të ishte më e përshtatshme të udhëtonin përmes:

- A) Ngushticës së Gjibraltarit.
- B) Detit të Veriut.
- C) Detit Mesdhe.
- D) Kanalit la Mansh.

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Përshkruan veçoritë kryesore fiziko- gjeografike dhe humane të rajonit të Evropës Perëndimore dhe Ishullore.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 3:

Shumë prej qyteteve më të mëdha të Evropës janë vendosur pranë lumenjve dhe brigjeve detare për shkak se:

- A) kjo vendndodhje u ka krijuar tradicionalisht akses në rrugët tregtare dhe udhëtimet.
- B) janë më të sigurt në lidhje me ndotjen.
- C) kanë më pak burime natyrore.
- D) kjo vendndodhje favorizon larminë e besimeve fetare.

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Identifikon veçoritë kryesore të zhvillimit të sotëm urban në Evropë.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 4:

Cili nga rajonet e Evropës dallohet për aktivitet më të lartë sizmik?

- A) Evropa Perëndimore.
- B) Evropa Ishullore.
- C) Evropa Lindore.
- D) Evropa Jugore.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Identifikon ngjashmëritë dhe dallimet në veçoritë kryesore fiziko-gjeografike dhe humane të rajoneve të Evropës.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 5:

Shënoni (V) për pohimet e vërteta dhe (G) për pohimet e gabuara:

- A) Pjesa më e madhe e ekonomisë së Meksikës zhvillohet me SHBA-në. _____
- B) Bujqësia e plantacioneve luan rolin kryesor në ekonominë e rajonit të Amerikës së Veriut. _____
- C) Rajoni më i urbanizuar në Amerikën Veriore është megalopoli përreth Liqeneve të Mëdha. _____
- D) Brazili dallohet për prodhime bujqësore. Ai zë vendin e parë në botë për prodhimin e elbit. _____

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.


Rezultati i të nxënit: Dallon tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik e shpërndarjes hapësinore të ekonomisë së Amerikës së Veriut, Amerikës së Mesme, Amerikës së Jugut.

Lloji i pyetjes: Pyetje “E vërtetë/E gabuar”.

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 6:

Parashikimet për tendencat rajonale të rritjes dhe zvogëlimit të popullsisë tregojnë se popullsia e botës, e cila aktualisht numëron 7,79 miliardë banorë, mund të tejkalojë shifrën 11 miliardë banorë në fund të shekullit. Vëzhgoni me kujdes grafikun e mëposhtëm të rritjes së popullsisë botërore gjatë periudhës 1800-2100.



- a) Referuar grafikut të rritjes vjetore të numrit të popullsisë së botës (në %), përcaktoni periudhën me rritjen më të ndjeshme të numrit të popullsisë.
- b) Identifikoni dy ndër shkaqet e rritjes së popullsisë në afërsisht 11 miliardë banorë deri në vitin 2100.
- c) Përcaktoni dy ndër pasojat që shoqërojnë rritjen e numrit të popullsisë në botë.

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik; marrja e vendimeve.

Rezultati i të nxënit: Diskuton mbi pasojat që shoqërojnë ritmet e ndryshme të rritjes së popullsisë sot në rajone të ndryshme; ndërton dhe interpreton grafikë, diagrame etj., që përshkruajnë dinamikat e popullsisë referuar shpërndarjes hapësinore.

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar.

Pikëzimi: 5 pikë

Pyetja 7:

Italia është një shtet i vendosur në pjesën jugore të Evropës, në gadishullin Apenin. Ajo kufizohet me Francën, Zvicrën, Austrinë dhe Slloveninë. Italia gjendet në koordinatat gjeografike $42^{\circ}50'V$, $12^{\circ}50'L$.

Gjatë periudhës 1861-1976 mbi 26 milion italianë emigruan në drejtim të vendeve të tjera të Evropës dhe të Amerikës. Pas vitit 1976 emigracioni filloi të reduktohej.

Pasi të lexoni tekstin përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

- a) Identifikoni dy tema gjeografike që përshkruhen në tekstin e mësipërm.
- b) Në cilën pjesë të tekstit përcaktohet vendndodhja absolute e Italisë. Po vendndodhja relative e saj?
- c) Përcaktoni në hartë, rajonin gjeografik të Evropës të cilit i përket Italia.
- d) Evidentoni dy ndër tiparet e proceseve migratore në Itali.



Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik; marrja e vendimeve.

Rezultati i të nxënit: Përshkruan veçoritë kryesore fiziko-gjeografike dhe humane të rajonit të Evropës mesdhetare.

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar.

Pikëzimi: 7 pikë

Pyetja 8:

Popullsia dhe ekonomia janë dy nga faktorët që e bëjnë Afrikën Veriore dhe Azinë Jugperëndimore të trajtohet si një rajon i veçantë.



- a) Jepni dy argumente pse turizmi është zhvilluar më shumë në Gadishullin Arabik, në krahasim me pjesën tjetër të rajonit.

b) Nafta përbën pasurinë bazë për zhvillimin e ekonomisë dhe rritjen e nivelit të jetesës në disa shtete të rajonit. Tregoni në hartë ku janë të përqendruara burimet natyrore të naftës.

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik; marrja e vendimeve.

Rezultati i të nxënit: Dallon tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik e shpërndarjes hapësinore të ekonomisë së rajonit të Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore.

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar.

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 9:

Afrika është kontinent që dallohet për pasuri të shumta natyrore. Pavarësisht këtij fakti, nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik, Afrika është kontinenti më i varfër. Të dhënat e Bankës Botërore (2021) tregojnë se në Afrikën Nënshahiane shkalla e varfërisë vazhdon të rritet, ndërsa numri i të varfërve është rritur me 18 milion nga viti 2015 në vitin 2018.

Pse Afrika është rajoni më i varfër, edhe pse ka pasuri të shumta natyrore? Përcaktoni dy ndër shkaqet që kanë ndikuar.

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik; marrja e vendimeve.

Rezultati i të nxënit: Dallon tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik e shpërndarjes hapësinore të ekonomisë së rajonit të Afrikës Nënshahiane.

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar.

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 10:

Popullsia e rajonit të Azisë Lindore dallohet për mbizotërimin e moshave të reja të popullsisë, sidomos në Kinë dhe në Korenë e Jugut. Në Japoni ndodh e kundërta, pasi grup-mosha 45-75 vjeç përbën më shumë se gjysmën e popullsisë.

- a) Përcaktoni një ndër shkaqet e këtij ndryshimi.
- b) Si quhet dukuria e mbizotërimit të moshave të vjetra në krahasim me moshat e reja në numrin e përgjithshëm të popullsisë, që po ndodh në Japoni?
- c) Jepni një shembull të një rajoni/vendi tjetër në të cilin po ndodh kjo dukuri.

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik; marrja e vendimeve.

Rezultati i të nxënit: Identifikon veçoritë e popullimit dhe kulturës së rajonit të Azisë Lindore.

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar.

Pikëzimi: 3 pikë

KLASA IX

Shqipëria dallohet për hidrografi të pasur dhe një rrjet të dendur lumor. Shumica e lumenjve burojnë nga zonat e larta malore. Referuar hartës së dhënë dhe grafikut përgjigjuni pyetjeve 1-3.



Pyetja 1:

Lumi më i gjatë i Shqipërisë është:

- A) Shkumbini
- B) Semani
- C) Vjosa
- D) Drini

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Identifikon tiparet e lumenjve dhe burimeve ujore në Shqipëri.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 2:

Vendosni në hartën e Shqipërisë shkronjat që i korrespondojnë elementeve hidrografike të mëposhtme:

- Me shkronjën A shënoni rrjedhën e poshtme të lumit Shkumbin.
- Me shkronjën B shënoni Liqenin e Prespës së Madhe.
- Me shkronjën C shënoni Lagunën e Nartës.
- Me shkronjën D shënoni Lumin Devoll.

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Identifikon tiparet e lumenjve dhe burimeve ujore në Shqipëri; përshkruan karakteristikat kryesore të liqeneve të Shqipërisë.


Lloji i pyetjes: Pyetje me plotësim.

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 3:

Grafiku tregon prurjet për lumin Valbona. Bazuar në të dhënat e grafikut, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

- Në cilin muaj janë regjistruar prurjet më të mëdha për lumin Valbona?
- Jepni një arsye për të mbështetur përgjigjen tuaj.
- Po prurjet më të ulëta, në cilin muaj janë regjistruar?



Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.


Rezultati i të nxënit: Ndërton dhe interpreton grafikët e regjimit të rrjedhjes së lumenjve kryesorë.

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar.

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 4:

Grafiku i mëposhtëm tregon shtimin natyror të popullsisë nga viti 1990 deri në vitin 2018.



Mbështetur në të dhënat që ofron grafiku:

- Gjeni cila është periudha me shtimin natyror më të lartë dhe më të ulët të popullsisë?
- Tregoni tendencën e shtimit natyror të popullsisë nga viti 1990-2018 (në rritje/në ulje).
- Përshkruani dy ndër faktorët që kanë ndikuar këtë tendencë të shtimit natyror të popullsisë.
- Identifikoni dy ndër pasojat që lidhen me tendencën e shtimit natyror të popullsisë.

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.

Rezultati i të nxënit: Ndërton dhe interpreton grafikë, diagrame për strukturën e popullsisë dhe harta të shpërndarjes gjeografike të saj.

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar.

Pikëzimi: 7 pikë

Llogara gjendet në Parkun Kombëtar të Llogarasë, pak më në veri të qafës me të njëjtin emër, 910 m mbi nivelin e detit. Parku i Llogarasë gjendet afro 40 km në juglindje të qytetit të Vlorës, në kufirin hapësinor midis detit Adriatik dhe Jon, në $40^{\circ}12'52''$ gjerësi gjeografike veriore dhe $19^{\circ}34'51''$ gjatësi gjeografike lindore. Parku ka një sipërfaqe rreth 1010 ha (10.1 km^2) dhe shkon nga lartësia 470 m në lartësinë 2018 m. Bimësia e zonës përbëhet kryesisht nga pyje masive me halorë të tillë si pisha e zezë dhe bredh, lisi etj. Afër Qafës së Llogarasë takohen drurë me forma kurorash mjaft interesante në të cilat është i dukshëm ndikimi i erërave. Një shembull mahnitës është “Pisha Flamur”, një monument i rrallë i natyrës me vlera shkencore dhe turistike. Parku i Llogarasë ka një rëndësi të madhe edhe si një destinacion turistik dhe shërben si një urë kalimi për bregdetin e Jonit. Ai ka potencial të madh për zhvillimin e eko-turizmit, sportet e ajrit, ekskursionet dhe udhëtimet. Ky është një vend klimatik sepse këtu përzihen të dyja klimat, malore dhe detare e freskët. Ky park ofron një peizazh tërheqës.

Referuar këtij informacioni përgjigjuni pyetjeve 5 dhe 6.

Pyetja 5:

Përcaktoni në hartën e Shqipërisë Qafën e Llogarasë dhe rajonin gjeografik në të cilin bën pjesë Parku Kombëtar i Llogarasë.

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.

Rezultati i të nxënit: Dallon veçoritë natyrore të Rajonit Jugor dhe lokalizon në hartë njësitë kryesore të relievit.

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar.

Pikëzimi: 2 pikë



Pyetja 6:

Duke përdorur informacionin që ofron teksti i mësipërm dhe njohuritë që ju keni në lidhje me Llogaranë, plotësoni tabelën e mëposhtme:

Vendndodhja absolute	Dy ndër faktorët që ndikojnë në tiparet e klimës	Tre ndër potencialet natyrore për zhvillimin e turizmit


Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.

Rezultati i të nxënit: Dallon veçoritë natyrore të Rajonit Jugor dhe lokalizon në hartë njësitë kryesore të relievit; vlerëson trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Jugor.

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar.

Pikëzimi: 6 pikë

Qytetet e Shkodrës dhe Korçës presin çdo vit me mijëra vizitorë nga vende të ndryshme të botës. Turistët shfaqin interes të lartë për t'u njohur nga afër me këto qytete pasi kanë marrë informacione për to nga interneti si dhe nga vetë vizitorët.



Pyetja 7:

- a) Qyteti i Shkodrës bën pjesë në Rajonin _____.
- b) Qyteti i Korçës bën pjesë në Rajonin _____.

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Dallon veçoritë kryesore natyrore të Rajonit Perëndimor dhe Juglindor dhe lokalizon në hartë njësitë kryesore të relievit.

Lloji i pyetjes: Pyetje me plotësim.

Pikëzimi: 2 pikë

Pyetja 8:

Evidentoni dy potenciale të rëndësishme turistike për qytetin e Shkodrës dhe dy potenciale të rëndësishme turistike për qytetin e Korçës.

Kompetenca: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Vlerëson trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Rajonit Perëndimor dhe Jugor.

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar.

Pikëzimi: 4 pikë

Pyetja 9:

Bazuar në potencialet natyrore dhe kulturore që qyteti i Shkodrës dhe Korçës ofrojnë, përcaktoni një ndër drejtimet e zhvillimit të ardhshëm ekonomik për secilin nga qytetet.

Kompetenca: Marrja e vendimeve.

Rezultati i të nxënit: Evidenton tiparet dhe drejtimin kryesor të aktivitetit aktual ekonomik të tij


Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar.

Pikëzimi: 2 pikë

KLASA X

Për t'ju përgjigjur pyetjes 1 dhe 2, referojuni figurës së mëposhtme.

Figura e mëposhtme tregon pozicionin e Tokës kundrejt Diellit më datë 21 qershor (solstici veror).



Pyetja 1:

Çfarë ndodh gjatë solsticit veror në Hemisferën Veriore?

- A) Gjatësia e ditës zvogëlohet duke shkuar drejt veriut.
- B) Gjatësia e ditës zgjatet duke shkuar drejt veriut.
- C) Dita është e barabartë me natën në Tropikun e Veriut.
- D) Dita zgjat 24 orë në Tropikun e Jugut.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik; marrja e vendimeve.

Rezultati i të nxënit: Dallon pasojat e qarkullimit të Tokës rreth Diellit.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 2:

Rrezet e Diellit gjatë solsticit veror bien pingul në:

- A) Ekuator.
- B) Tropikun e Veriut.
- C) Tropikun e Jugut.
- D) Rrethin Polar të Jugut.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik; marrja e vendimeve.


Rezultati i të nxënit: Dallon pasojat e qarkullimit të Tokës rreth Diellit.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 3:

Në hartën e mëposhtme jepet vendndodhja e Singaporit në hartën e botës.



Në rast se në Singapor Dielli ka lindur në orën 7 të mëngjesit, në cilën orë do të perëndojë ai?

- A) Në orën 18.
- B) Në orën 19.
- C) Në orën 22.
- D) Në orën 23.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.


Rezultati i të nxënit: Tregon lidhjen midis pozicionit të Tokës kundrejt Diellit dhe gjatësisë së ditës dhe natës.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 4:

Në hartën e mëposhtme jepet shpërndarja e rrymave oqeanike.



Bazuar te harta dhe në njohuritë tuaja, cila është tendenca e lëvizjeve të rrymave oqeanike?

- A) Rrymat oqeanike të ftohta lëvizin nga gjerësitë e ulëta gjeografike drejt gjerësive më të mëdha gjeografike.
- B) Rrymat oqeanike të ngrohta lëvizin nga gjerësitë e ulëta gjeografike drejt gjerësive më të mëdha gjeografike.
- C) Rrymat oqeanike të ftohta lëvizin vetëm në zonat e ftohta polare.
- D) Rrymat oqeanike të ngrohta lëvizin vetëm në zonat e ngrohta ekuatoriale.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Analizon lëvizjen e rrymave oqeanike.

Lloji i pyetjes: Me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Për t'ju përgjigjur pyetjes 5 dhe 6, referojuni tabelës së mëposhtme.

Më poshtë paraqitet një tabelë me të dhëna që tregojnë ndryshimin e temperaturës dhe trysnisë atmosferike në drejtim vertikal.

Lartësia (m)	Temperatura (°C)	Trysnia atmosferike (mb)
0	15	1013
1200	7	875
2400	-1	752
4500	-15	572
6000	-25	466
7500	-34	376

Pyetja 5:

Bazuar në të dhënat e tabelës, përcaktoni çfarë ndodh me trysninë atmosferike ndërkohë që rritet lartësia.

- A) Trysnia atmosferike rritet.
- B) Trysnia atmosferike zvogëlohet.
- C) Trysnia atmosferike nuk ndryshon.
- D) Trysnia atmosferike herë rritet dhe herë zvogëlohet.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.

Rezultati i të nxënit: Analizon ndryshimin e trysnisë atmosferike në hapësirë.

Lloji i pyetjes: Pyetje me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 6:

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme shohim se, në lartësinë 7500 m temperatura është -34°C dhe trysnia atmosferike 376 mb. Me çfarë problemi tjetër do të përballej një njeri, nëse ngjitej në këto lartësi, përveçse me temperaturat e ulëta dhe ndjesinë e të ftohtit të madh?

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.

Rezultati i të nxënit: Analizon ndryshimin e trysnisë atmosferike në hapësirë.

Lloji i pyetjes: Pyetje me përgjigje të shkurtër.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 7:

Vendosni shkronjën a, b, c përbri shkëmbinjve për t'i lidhur ata me shkëmbin mëmë nga i cili janë formuar:

1. _____
2. _____
3. _____

Shkëmbi	Shkëmbi mëmë
1. Bazalte	a. Magmatik
2. Gips	b. Metamorfik
3. Kuarcit	c. Sedimentar

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Përshkruan kushtet e formimit të shkëmbinjve.


Lloji i pyetjes: Pyetje me çiftim.

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 8:

La Plata është sistemi i dytë lumor për nga madhësia në Amerikën Jugore. Me 4 milion km katror të sipërfaqes së pellgut, La Plata vjen menjëherë pas pellgut të Amazonës në vendin e dytë.

Në figurën e mëposhtme paraqitet grykëderdhja e lumit La Plata.



- a) Përcaktoni tipin e grykëderdhjes së lumit.
- b) Argumentoni dy faktorë që ndikojnë në krijimin e një tipi të tillë grykëderdhje.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Analizon veprimtarinë gërryese, transportuese dhe depozituese të ujërave rrjedhëse.

Lloji i pyetjes: Pyetje e strukturuar.

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 9:

Gjatë një udhëtimi që zhvilloi një grup nxënësish në disa prej zonave të rajonit të Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore, ju bënë përshtypje në mënyrë të veçantë dunat e rërës dhe kërpudhat shkëmbore.



- a) Jepni një veçori të përbashkët midis dunave dhe kërpudhave shkëmbore në lidhje me mënyrën e formimit.
- b) Jepni një ndryshim midis tyre në drejtim të mënyrës së formimit.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.


Rezultati i të nxënit: Analizon veprimtarinë gërryese, transportuese dhe grumbulluese të erës.


Lloji i pyetjes: E strukturuar.

Pikëzimi: 2 pikë

Pyetja 10:

Lëvizjet e pllakave tektonike formojnë tipa të ndryshëm kufijsh midis tyre, siç tregohen në figurat e mëposhtme.



- 
- a) Cila nga figurat shpjegon teorinë e zgjerimit të tabanit të oqeaneve?
- b) Cila nga figurat tregon formimin e humnerave oqeanike? Shpjegoni se si ndodh procesi i formimit të humnerave oqeanike.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Analizon lëvizjen e pllakave tektonike.


Lloji i pyetjes: E strukturuar.

Pikëzimi: 3 pikë

KLASA XI

Pyetja 1:

Harta e mëposhtme paraqet dendësinë e popullsisë së Shqipërisë për vitin 2017, sipas INSTAT.



Referuar të dhënave të hartës, përcaktoni cili nga qarqet ka dendësinë më të ulët të popullsisë?

- A) Qarku i Gjirokastrës dhe Kukësit.
- B) Qarku i Korçës dhe Elbasanit
- C) Qarku i Dibrës dhe Lezhës
- D) Qarku i Fierit dhe Vlorës

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.

Rezultati i të nxënit: Dallon në hartë shpërndarjen e popullsisë.

Lloji i pyetjes: Me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 2:

Pas vitit 1990 e në vazhdim, numri i popullsisë së Shqipërisë pati një rënie të ndjeshme. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rënien e numrit të popullsisë, kanë qenë:

- A) rritja e nivelit të vdekshmërisë foshnjore;
- B) shtimi i ulët natyror dhe imigracioni i lartë;
- C) rritja e numrit të vdekjeve në moshën e tretë;
- D) shtimi i ulët natyror dhe emigracioni i lartë.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.


Rezultati i të nxënit: Dallon faktorët që ndikojnë në numrin e popullsisë së Shqipërisë.

Lloji i pyetjes: Me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 3:

Për t'ju përgjigjur pyetjeve 3 – 5, referojuni grafikëve të mëposhtëm.



Më poshtë paraqiten grafikët e grup-moshave të popullsisë së Shqipërisë për vitin 2001 dhe 2020.

Krahasoni të dy grafikët dhe nxirrni nga një përfundim në lidhje me:

- grup-moshën nën moshën e punës.
- grup-moshën në moshën e punës.
- grup-moshën mbi moshën e punës.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.

Rezultati i të nxënit: Interpreton ecurinë e zhvillimit të popullsisë.

Lloji i pyetjes: E strukturuar.

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 4:

Cili është faktori kryesor që ka ndikuar në këto ndryshime të strukturës moshore të popullsisë?

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.

Rezultati i të nxënit: Interpreton ecurinë e zhvillimit të popullsisë.

Lloji i pyetjes: Me përgjigje të shkurtër.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 5:

Supozojmë se tendenca e ndryshimit të strukturës moshore për vitet në vazhdim do të jetë e njëjtë. Cili do të ishte një nga problemet në aspektin ekonomik për Shqipërinë?

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.


Rezultati i të nxënit: Interpreton ecurinë e zhvillimit të popullsisë.

Lloji i pyetjes: Me përgjigje të shkurtër.

Pikëzimi: 1 pikë

Për t'ju përgjigjur pyetjeve 6 – 7, referojuni hartës së mëposhtme.

Harta e mëposhtme paraqet rrjetin hidrografik të Shqipërisë. Shqipëria përshkohet nga një rrjet i dendur lumenjsh.



Pyetja 6:

Emërtoni lumenjtë e Shqipërisë që tregohen në hartë me numrat 1, 2 dhe 3.

1 _____

2 _____

3 _____

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Identifikon në hartë lumenjtë e Shqipërisë.

Lloji i pyetjes: E strukturuar.

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 7:

Një shoku juaj interesohet për lagunat e Shqipërisë, pasi ka dëgjuar që ato kanë një biodiversitet të pasur. Bëni një udhëtim imagjinar për t'i treguar shokut tuaj lagunat, dhe emërtoni tri prej tyre, sipas orientimeve të mëposhtme:

- Laguna që gjendet në zonën midis Shkumbinit dhe Semanit: _____
- Laguna që gjendet midis Vjosës dhe gjirit të Vlorës: _____
- Laguna që gjendet në skajin më jugor të Shqipërisë: _____

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.


Rezultati i të nxënit: Identifikon në hartë lagunat e Shqipërisë.

Lloji i pyetjes: E strukturuar.

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 8:

Më poshtë jepen piramidat e popullsisë së Shqipërisë nga viti 1979 deri në vitin 2011.



- Cili është ndryshimi thelbësor midis piramidës së vitit 1979 dhe piramidës së vitit 2011 për nivelin e lindshmërisë?
- Jepni një argument për të mbështetur përgjigjen tuaj për kërkesën a), bazuar vetëm në të dhënat e grafikëve.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.

Rezultati i të nxënit: Analizon ecurinë e numrit të përgjithshëm të popullsisë së Shqipërisë përgjatë periudhave të ndryshme.

Lloji i pyetjes: E strukturuar.

Pikëzimi: 2 pikë

Pyetja 9:

Rajoni Jugor dhe Juglindor ndryshojnë midis tyre në lidhje me veçoritë fiziko-gjeografike.

- a) Jepni një ndryshim midis këtyre dy rajoneve, lidhur me strukturat tektonike mbizotëruese ku formohet relievi.
- b) Emërtoni një nga pjesët përbërëse të Rajonit Jugor, që është formuar në një graben.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.

Rezultati i të nxënit: Krahason rajonet gjeografike të Shqipërisë në aspektin natyror.

Lloji i pyetjes: E strukturuar.

Pikëzimi: 3 pikë

Pyetja 10:

Shqipëria përgjatë viteve ka kaluar në disa faza të zhvillimit ekonomik. Përcaktoni nga një veçori specifike të ekonomisë gjatë periudhave të mëposhtme.

- a) Para viteve 1945

_____.

- b) Vitet 1945-1990

_____.

- c) Pas viteve 1990

_____.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike; përpunimi i informacionit gjeografik.

Rezultati i të nxënit: Përshkruan tiparet e përgjithshme të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, duke analizuar ecurinë e tyre përgjatë periudhave të ndryshme.

Lloji i pyetjes: E strukturuar.

Pikëzimi: 3 pikë

KLASA XII

Pyetja 1:

Në cilin nga rajonet e Evropës është më shumë i zhvilluar turizmi detar?

- A) Në Evropën Perëndimore.
- B) Në Evropën Ishullore.
- C) Në Evropën Lindore.
- D) Në Evropën Jugore.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Identifikon tipare të zhvillimit ekonomik të rajoneve të Evropës.

Lloji i pyetjes: Me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 2:

Cili nga vendet e Evropës Veriore dallohet për numrin e madh të liqeneve?

- A) Islanda.
- B) Norvegjia.
- C) Suedia.
- D) Finlanda.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Dallon veçoritë fiziko-gjeografike të rajoneve të Evropës.

Lloji i pyetjes: Me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 3:

Cilët nga shtetet e mëposhtme bëjnë pjesë në rajonin e Evropës Perëndimore?

- A) Franca, Gjermania dhe Danimarka.
- B) Franca, Gjermania dhe Beneluksi.
- C) Franca, Gjermania dhe Spanja.
- D) Franca, Gjermania dhe Italia.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Dallon rajonet e Evropës.

Lloji i pyetjes: Me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 4:

Pjesa më e madhe e popullsisë në Evropën Lindore i përket besimit:

- A) protestant;
- B) mysliman;
- C) ortodoks;
- D) katolik.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Tregon shpërndarjen hapësinore të besimeve fetare.

Lloji i pyetjes: Me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 5:

Cili nga rajonet e Evropës dallohet për aktivitet më të lartë sizmik?

- A) Evropa Perëndimore
- B) Evropa Ishullore
- C) Evropa Lindore.
- D) Evropa Jugore.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Përshkruan tiparet specifike të rajoneve të Evropës.

Lloji i pyetjes: Me alternativa.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 6:

Evropa është kontinenti ku pesë nga shtetet e tij bëjnë pjesë në G8. Grupi i tetëshes (G8) është një forum ndërkombëtar i përbërë prej tetë shteteve më të industrializuara, përfaqësuesit e të cilëve mbledhen çdo vit të diskutojnë në përgjithësi çështjet e rëndësishme ekonomike, por edhe ato politike të botës në veçanti. Këto shtete përbëjnë 65 % të ekonomisë botërore.

- a) Emërtoni një nga shtetet e Evropës që bën pjesë në G8.
- b) Përcaktoni një ndër degët e ekonomisë së Evropës, që e ka rritur peshën e saj në raport me sektorët e tjerë të ekonomisë?

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Përshkruan tiparet ekonomike të Evropës.

Lloji i pyetjes: E strukturuar.

Pikëzimi: 2 pikë

Pyetja 7:

Sektori i tretë i ekonomisë (shërbimet) përbën sektorin më të rëndësishëm të jetës ekonomike të Evropës. Pse ndërtimi i korridoreve automobilistike ndikon shumë në zhvillimin e sektorit të tretë?

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Përshkruan tiparet e sektorëve të ekonomisë në Evropë.

Lloji i pyetjes: E strukturuar.

Pikëzimi: 1 pikë

Pyetja 8:

Për t'ju përgjigjur pyetjes, bazohuni në hartën e mëposhtme.



a) Cili rajon tregohet në hartë?

b) Identifikoni emrat e dy lumenjve më të rëndësishëm të këtij rajoni.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Identifikon në hartë rajonet e botës.

Lloji i pyetjes: E strukturuar.

Pikëzimi: 2 pikë

Pyetja 9:

Në hartën e mëposhtme tregohet vendndodhja e ishujve Lofoten të Norvegjisë.

Supozojmë që do të bënit një fletëpalosje për turizmin në këto ishuj për muajin qershor.

Cilat do të ishin dy dukuritë natyrore më interesante që ndodhin në këto ishuj, që do t'i bindte turistët të zgjidhnin ishujt Lofoten për të kaluar pushimet?

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Dallon atraksionet e veçanta turistike të vendeve të ndryshme.

Lloji i pyetjes: E strukturuar.

Pikëzimi: 2 pikë



Pyetja 10:

Në kolonën e majtë jepen disa nga shtetet e Evropës, ndërsa në kolonën e djathtë karakteristikat e tyre. Lidhni me shigjetë shtetin me karakteristikën përkatëse.

Finlanda	Ka të zhvilluar turizmin balnear.
Norvegjia	Dallohet për fjordet e shumta.
Italia	Reshjet arrijnë deri në 10 000mm/vit.
Holanda	Ka reliev kryesisht fushor. Dallohet për liqenet e shumta.

Kompetencat: Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Rezultati i të nxënit: Dallon veçoritë e përgjithshme të vendeve të Evropës.

Lloji i pyetjes: Me çiftim.

Pikëzimi: 4 pikë



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

www.ascap.edu.al

sekretaria@ascap.edu.al

